



PASQYRË KRAHASUESE E PERCEPTIMEVE PËR INSTITUCIONET PUBLIKE NGA TË ANKETUARIT NË KOSOVË DHE SERBI

RAPORT I SHKURTË
KRAHASIMOR

B S BAROMETRI I SIGURISË NË
B P BALLKANIN PERËNDIMOR

2020 BOTIMI I PARË I
ANKETIMIT RAJONAL



Autor: Plator Avdiu

Metodolog: Mentor Vrajolli

Redaktorë të brendshëm: Shpat Balaj, KCSS
Bojan Elek, BCSP

Recenzent i jashtëm: Florian Qehaja

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të marra nga të anketuarit dhe demonstrojnë vetëm mënyrën si i perceptojnë njerëzit institucionet. Ato në asnjë mënyrë nuk paraqesin ndonjë vlerësim përfundimtar të punës së institucioneve subjekt i këtij studimi. Raporti u shërben si instrument për të adresuar mangësitë e mundshme por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Qendrës së Beogradit për Politikën e Sigurisë. Opinione të shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e fondacionit National Endowment for Democracy (NED).

PASQYRË KRAHASUESE E PERCEPTIMEVE PËR INSTITUCIONET PUBLIKE NGA TË ANKETUARIT NË KOSOVË DHE SERBI

**RAPORT I SHKURTË
KRAHASIMOR**

W B BAROMETRI I
SIGURISË NË
S B BALLKANIN
PERËNDIMOR

DHJETOR 2020

PROJEKTI MBËSHTETUR NGA:



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
PERCEPTIMET PËR INSTITUCIONET PUBLIKE NË KOSOVË DHE SERBI: BESIMI, KONTAKTI DHE KORRUPSIONI	3
1.INSTITUCIONET PUBLIKE MË TË BESUARA NË KOSOVË DHE SERBI.....	4
2.INSTITUCIONET PUBLIKE MË PAK TË BESUARA NË KOSOVË DHE SERBI...	7
3.KONTAKTET E DREJTPËRDREJTA TË QYTETARËVE ME INSTITUCIONET PUBLIKE NË KOSOVË DHE SERBI	11
4.INSTITUCIONET PUBLIKE MË TË KORRUPTUARA NË KOSOVË DHE SERBI. . .	12
5.INSTITUCIONET PUBLIKE MË PAK TË KORRUPTUARA NË KOSOVË DHE SERBI....	14
METODOLOGJIA.....	16

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo pasqyrë është një nga produktet e projektit rajonal “**Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor**” (BSBP), të udhëhequr nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në partneritet me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi. Marrë parasysh kompleksitetet dhe dialogun politik në vazhdim mes Kosovës dhe Serbisë që potencialisht mund të çojë drejt zgjidhjes, projekti u iniciua duke lansuar anketën e parë rajonale që i targeton të dyja vendet. Ky botim i BSBP-së paraqet gjetjet e kësaj ankete të kryer njëkohësisht në Kosovë dhe Serbi gjatë periudhës shtator-tetor 2020.

Të dyja organizatat, QKSS-ja dhe BCSP-ja, i kanë publikuar raportet e tyre përkatëse të vendeve, në të cilat analizohen dhe interpretohen në mënyrë sasiore të dhënat për çështjet vijuese: i) besimi në institucionet e sigurisë, të drejtësisë, qendrore dhe lokale në Kosovë dhe Serbi, ii) shpeshësia e kontaktit të drejtpërdrejtë të të anketuarve me institucionet kyçe të sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë dhe Serbi, dhe iii) perceptimet e të anketuarve në lidhje me përhapjen e korrupsionit në institucionet kyçe në Kosovë dhe Serbi. Kjo pasqyrë krahasuese shërben si përmbledhje e gjetjeve kyçe të të dy raporteve të vendeve dhe si mjet për të krahasuar perceptimet për institucionet publike nga të anketuarit kosovarë dhe serbë.

Gjetjet kyçe në lidhje me besimin, perceptimin për korrupsionin dhe shpeshësinë e kontakteve me institucionet publike nga qytetarët e të dy vendeve përkatësisht, janë si më poshtë:

- Përgjithësisht, në Kosovë duket se institucionet e sigurisë janë ato që gëzojnë nivelet më të larta të besimit publik, dhe pas tyre vijnë komunat, kurse në Serbi më të besuarat rezultuan institucionet qendrore, pas të cilave vijnë institucionet e sigurisë.

- Kur flitet për besimin, motivi i përbashkët që rrjedh nga përgjigjet e qytetarëve në të dy vendet është se institucionet e sigurisë, dhe në veçanti ushtrinë, i konsiderojnë ndër më të besuarit. Në të njëjtën kohë, institucionet e drejtësisë konsiderohen ndër më pak të besuarat nga të anketuarit në të dy vendet, dhe ky është treguesi kyç i pranisë së korrupsionit të përhapur në nivelet e larta në të dy shoqëritë.

- Pyetjet e hapura të anketës tregojnë se në të dy vendet nuk është i vogël numri i të anketuarve që nuk kanë aspak besim në asnjë institucion - në Serbi janë 15 për qind, kurse në Kosovë 12 për qind.

- Me dallime të vogla, ngjashmëritë në perceptime mes të anketuarve në Kosovë dhe Serbi u vunë re edhe në lidhje me korrupsionin. Në Kosovë, institucionet e perceptuar si më të korruptuara rezultuan të jenë Qeveria, Gjykatat, Prokuroria dhe Doganat, kurse ato më pak të korruptuara u konsideruan Forca e Sigurisë së Kosovës, pas së cilës vijnë Shërbimi Korrektues i Kosovës, Policia e Kosovës dhe komunat. Në Serbi, institucionet e perceptuara si më të korruptuara janë Prokuroria, Gjykatat, Policia e Serbisë, Qeveria dhe komunat, kurse Forcat e Armatosura dhe Shërbimi Korrektues rezultuan institucionet që perceptohen si më pak të korruptuara.

- Rezultatet e anketës të BSBP-së tregojnë edhe shpeshësinë e ulët të ndërveprimit me institucionet nga të anketuarit në të dy vendet, dhe vetëm komunat dhe policia rezultuan të jenë institucionet me të cilat qytetarët e tyre përkatës kanë kontakte më të shpeshta.

PERCEPTIMET PËR INSTITUCIONET PUBLIKE NË KOSOVË DHE SERBI:

Besimi, Kontakti dhe Korrupsioni


1. Institucionet publike më të besuara në Kosovë dhe Serbi


Rezultatet e BSBP-së 2020 tregojnë se të anketuarit në Kosovë dhe Serbi kanë perceptime të ndryshme në lidhje me besimin e tyre në institucionet publike në vendet përkatëse.

Në këtë aspekt, bazuar në rezultatet e mbledhura në Kosovë, institucionet më të besuara publike janë kryesisht institucionet e sigurisë dhe komunat. Më saktësisht, lista e Kosovës kryesohet nga Forca e Sigurisë së Kosovës (me gjithsej 81 për qind të të anketuarve që kanë shkallë të ndryshme të besimit), pasuar nga Policia e Kosovës (62 për qind), kryetarët e komunave (52 për qind), Inspektorati Policor i Kosovës (49 për qind) dhe administrata e komunave (45 për qind).

Nga ana tjetër, edhe pse institucionet e sigurisë së Serbisë, në mënyrë të ngjashme me ato të Kosovës, renditen ndër institucionet më të besuara nga të anketuarit, në krahasim me Kosovë niveli i besimit të të anketuarve në institucionet serbe sigurisë duket të jetë dukshëm më i ulët. Forcat e Armatosura Serbe janë institucioni më i besuar në Serbi, nga më shumë se gjysma e të anketuarve (rreth 58 për qind), pasuar nga institucione të tjera publike tek të cila besimi është i mirë, si: Presidenti i Serbisë (39 për qind), Shërbimi Korrektues/zyrtarët e burgjeve (34 për qind), Qeveria e Serbisë (31 për qind) dhe Policia e Serbisë (30 për qind). Vlen të përmendet se ka dallime shumë të mëdha në aspektin e besimit të publikut në institucionet policore në Kosovë dhe Serbi - teksa 62 për qind e të anketuarve kosovarë priren të kenë besim të fortë në Policinë e Kosovës, besimi në polici është më i ulët në Serbi, me vetëm 30 për qind të të anketuarve që kanë besim të fortë tek Policia. Sidoqoftë, rezultatet e besimit në Policinë Serbe tregojnë se rreth 23 për qind e të anketuarve kanë deri diku besim në këtë institucion të sigurisë.

TABELA 1 INSTITUCIONET PUBLIKE MË TË BESUARA NË KOSOVË (SIPAS REZULTATEVE TË PYETJEVE TË MBYLLURA):






BSBP-ja 2020 kishte një pyetje specifike të hapur, pa mundësi të paracaktuara, se cilit institucion i besojnë më shumë të anketuarit. Policia e Kosovës u rendit në vend të parë nga të anketuarit, me 41 për qind, dhe pas saj vjen Forca e Sigurisë së Kosovës me 17 për qind. Sidoqoftë, është e rëndësishme të vërehet se numri i të anketuarve që nuk kanë besim në asnjë institucion është 12 për qind në total.

Ndërkohë, të anketuarit në Serbi i renditën Forcat e Armatosura si më të besuarat me 22 për qind, që kur krahasohet me Kosovën është vlerë dukshëm më e ulët se ajo për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Institucioni i dytë më i besuar u rendit Policia e Serbisë me 14 për qind. Sidoqoftë, mund të vërehet se numri i të anketuarve që nuk shfaqin besim në asnjë institucion serb është më i lartë se për institucionet e Kosovës - nga 15 për qind në Serbi në 12 për qind në Kosovë.

TABELA 2 DHJETË INSTITUCIONET MË TË BESUARA (SIPAS REZULTATEVE TË PYETJEVE TË HAPURA):




2. Institucionet publike më pak të besuara në Kosovë dhe Serbi

Sa u përket institucioneve më pak të besuara në Kosovë, interpretimi i të dhënave të BSBP-së tregon se kur flitet për institucionet qendrore, Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës janë më pak të besuarat nga të anketuarit kosovarë. Niveli i ulët i besimit në të dy institucionet qendrore tregon se ato nuk perceptohen pozitivisht nga të anketuarit, pasi më pak se 20 për qind e tyre kanë besim në këto institucione. Kështu, institucioni më pak i besuar në Kosovë është Qeveria, me 13% të të anketuarve që kanë besim në të (ndërsa 70 për qind e tyre nuk kanë besim), e ndjekur nga afër nga Kuvendi i Kosovës, me 16 për qind të të anketuarve që deklarojnë se kanë besim në punën e Kuvendit (ndërsa 58 për qind e tyre nuk kanë besim).

Lista e institucioneve publike më pak të besuara nga të anketuarit kosovarë vazhdon me Agjencinë Kundër Korrupsionit (21 për qind e të anketuarve kanë besim në të), Presidentin e Kosovës (22 për qind e të anketuarve kanë besim në këtë institucion), Gjykatat (26 për qind e të anketuarve kanë besim në to), Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (29 për qind e të anketuarve kanë besim në të) dhe Prokurorinë (30 për qind e të anketuarve kanë besim në të). Niveli i besimit është pak më i lartë në Shërbimin Korrektues të Kosovës (34 për qind e të anketuarve kanë besim në të) dhe Doganën e Kosovës (38 për qind e të anketuarve kanë besim në të), siç tregohet në tabelën më poshtë.


Nga ana tjetër, institucionet më pak të besuara në Serbi kanë rezultuar të jenë institucionet e drejtësisë dhe sundimit të ligjit. Bazuar në të dhënat e mbledhura në Serbi, Gjykatat dhe Prokuroria janë institucionet më pak të besuara në Serbi, me vetëm rreth 20 për qind të të anketuarve që kanë besim në to, ndërsa niveli i mosbesimit në Prokurori dhe në Gjykata është rreth 54 për qind dhe 53 për qind, përkatësisht. Institucionet e tjera serbe në të cilat të anketuarit kanë nivele të ulëta besimi janë Agjencia Kundër Korrupsionit (21 për qind e të anketuarve kanë besim në të), Dogana (24 për qind e të anketuarve kanë besim në të), administrata komunale/e qytetit (24 për qind e të anketuarve kanë besim në to), Parlamenti i Serbisë (26 për qind e të anketuarve kanë besim në të), Kryetarët e Komunave (26 për qind e të anketuarve kanë besim në ta) dhe Agjencia për Informacion të Sigurisë (29 për qind e të anketuarve kanë besim në të).

TABELA 3 INSTITUCIONET PUBLIKE MË PAK TË BESUARA (SIPAS REZULTATEVE TË PYETJE TË MBYLLURA):






PROKURORIA




PROKURORIA




AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT




AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT




DOGANAT E KOSOVËS



DOGANAT




KUVENDI I KOSOVËS



PARLAMENTI I SERBISË






Përveç pyetjes së mbyllur, anketa u mundësoi të anketuarve edhe të deklarojnë se cilit institucion i besojnë më pak në të dy vendet. Në këtë aspekt, institucionet më pak të besuara në Kosovë janë ato qendrore, për të cilat 41 për qind e të anketuarve raportojnë mosbesim, dhe në vend të dytë ndër institucionet më pak të besuara renditen ato të drejtësisë, me 17 për qind të të anketuarve që raportojnë mosbesim.

Ndërkohë, rezultatet e anketës në Serbi shfaqin një ndryshim të madh me ato në Kosovë. Për shembull, kjo pyetje e hapur ka treguar se Gjykatat dhe Policia e Serbisë janë institucionet më pak të besuara, dhe ndajnë përqindje të ngjashme - 20 për qind secila. Pas tyre vijnë institucionet qendrore, spitalet dhe institucionet e tjera të renditura nga të anketuarit si institucionet më pak të besuara.

TABELA 4 DHJETË INSTITUCIONET MË TË PABESUARA (SIPAS REZULTATEVE TË PYETJEVE TË MBYLLURA):



3. Kontaktet e drejtpërdrejta të qytetarëve me institucionet publike në Kosovë dhe Serbi

Ky botim i BSBP-së ka matur edhe shpeshësinë e kontakteve të drejtpërdrejta të të anketuarve gjatë 12 muajve të fundit me disa nga institucionet e përzgjedhura në Kosovë dhe Serbi.

Të dhënat japin rezultate pothuajse të ngjashme në të dy vendet. Kështu, komunat renditen të parat ndër institucionet publike me të cilat të anketuarit kanë pasur më shpesh kontakte të drejtpërdrejta (48 për qind në Kosovë krahasuar me 50 për qind në Serbi). Ato ndiqen nga institucionet policore në të dy vendet (22 për qind në Kosovë dhe 25 për qind në Serbi), gjykatat (13 për qind në Kosovë dhe 22 për qind në Serbi), Inspektorati Policor i Kosovës (4 për qind në Kosovë - kjo vlen vetëm për Kosovën)) dhe qeveritë (4 për qind në Kosovë dhe 5 për qind në Serbi).

TABELA 5 SHPESHËSIA E KONTAKTEVE TË DREJTPËRDREJTA TË QYTETARËVE GJATË 12 MUAJVE TË FUNDIT ME INSTITUCIONET PUBLIKE

KOSOVA			SERBIA		
	Jo	PO		Jo	PO
Komunat	51%	48%	Komunat	50%	50%
Policia e Kosovës	78%	22%	Policia	76%	25%
Gjykatat	87%	13%	Gjykatat	78%	22%
Inspektorati Policor i Kosovës	96%	4%	Qeveria	95%	5%
Qeveria	96%	4%			


4. Institucionet publike më të korrupuara në Kosovë dhe Serbi

Sa i përket perceptimit të të anketuarve për përhapjen e korrupsionit, institucioni më i korruptuar perceptohet të jetë Qeveria e Kosovës, me 72 për qind të të anketuarve që e shprehin këtë pikëpamje. Në vend të dytë dhe të treta për sa i përket perceptimit si më të korruptuar janë Gjykatat dhe Prokuroria, përkatësisht nga 45 për qind dhe 43 për qind e të anketuarve. Dogana e Kosovës perceptohet të jetë më pak e korruptuar, me 33 për qind të të anketuarve që besojnë se doganat janë të korrupuara.

Në Serbi, Dogana perceptohet si institucioni më i korruptuar nga 53 për qind e të anketuarve, dhe pas saj vjen Prokuroria (52 për qind), Gjykatat (52 për qind), Policia (51 për qind), Qeveria (51 për qind) dhe administrata komunale/e qytetit (50 për qind)


Siç dëshmohet nga rezultatet e anketës, ka dallime të konsiderueshme në perceptimin e të anketuarve për institucionet publike më të korrupuara në Kosovë dhe Serbi. Teksa të anketuarit kosovarë i kanë renditur Policinë e Kosovës dhe komnat (për më shumë detaje shih pjesën tjetër të pasqyrës) si më pak të prekura nga fenomeni i korrupsionit, në Serbi gjysma e të anketuarve perceptojnë se këto institucione janë të korrupuara.

TABELA 6 INSTITUCIONET PUBLIKE MË TË KORRUPTUARA (SIPAS REZULTATEVE TË PYETJEVE TË MBYLLURA):







QEVERIA E KOSOVËS




GJYKATAT




QEVERIA




GJYKATAT



POLICIA



ADMINISTRATA KOMUNALE/E QYTETIT




5. Institucionet publike më pak të korrupuara në Kosovë dhe Serbi

Institucionet e sigurisë së Kosovës perceptohen si institucionet më pak të korrupuara nga të anketuarit në vend. Në këtë aspekt, Forca e Sigurisë së Kosovës kryeson listën e renditjes së institucioneve më pak të korrupuara, pasi vetëm 8 për qind e të anketuarve e perceptojnë se është prekur nga korrupsioni, ndërsa 75 për qind e tyre ndanë pikëpamjen se nuk është e korrupsionuar. Sidoqoftë, rreth 6 për qind e të anketuarve u përgjigjën se Forca e Sigurisë së Kosovës është deri diku e korrupsionuar, dhe rreth 11 për qind e tyre nuk u përgjigjën ose nuk kishin opinion këtë çështje.

Veç kësaj, institucionet e tjera publike që të anketuarit i perceptojnë më pak të korrupsionuar janë Shërbimi Korrektues i Kosovës (perceptohet si i korrupsionuar nga 22 për qind e të anketuarve), Policia e Kosovës (perceptohet si e korrupsionuar nga 27 për qind e të anketuarve) dhe Komunitatet (perceptohen si të korrupsionuar nga 30 për qind e të anketuarve)


Në mënyrë të ngjashme, institucioni më pak i korrupsionuar në Serbi kanë rezultuar Forcat e Armatosura, të perceptuara si të korrupsionuar nga gjithsej 18 për qind e të anketuarve, dhe pas tyre vijon Shërbimi Korrektues/Zyrtarët e Burgjeve, të perceptuar si të korrupsionuar nga rreth 32 për qind e të anketuarve.

TABELA 7 INSTITUCIONET PUBLIKE MË PAK TË KORRUPTUARA (SIPAS REZULTATEVE TË PYETJEVE TË MBYLLURA)






POLICIA E KOSOVËS



KOMUNAT



METODOLOGJIA

Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor konsiston në një kombinim të metodave sasore dhe cilësore që japin rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat mbledhen përmes teknikës së intervistave sy më sy me të anketuarit e përzgjedhur në mënyrë rastësore në mbarë territorin e të dy vendeve - Kosovë dhe Serbi. Hulumtimi në terren në të dy vendet u zhvillua nga fundi i shtatorit deri në fillim të tetorit 2020, dhe u krye nga ekipet përkatëse të hulumtuesve në terren të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe të agjencisë Sprint në Serbi.

Pyetësi përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura që i lejojnë të anketuarve të japin mendimet e tyre pa mundësi të paracaktuara. Mostra kombëtare në Kosovë, nga e cila u hartua hulumtimi, paraqet 1,132 amvisëri, duke përbërë kështu një mostrim përfaqësues të popullsisë mbi 18 vjeç në Kosovë. Korniza e mostrës u bazua në zonat e kodit telefonik, dhe si të tilla përfshihen 8 rajonet e mëposhtme: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë të Jugut, Mitrovicë të Veriut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Faza e parë e grumbullimit gjeografik u bazua në Raportin e Regjistrimit të Kosovës të vitit 2012. Faza e dytë përfshiu grupimin e mostrave sipas zonës së komunës me një mostër të shtresuar rurale/urbane sipas numrit të amvisërive. Faza e fundit përdori metodën e mostrës së rastësishme duke përdorur metodën e datëlindjes më të afërt. Marrja e mostrave të rastit siguron që çdo banor në Kosovë ka probabilitet të barabartë për të qenë i zgjedhur për një intervistë. Me mostrën e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë prirjet në qëndrimet dhe perceptimet në mesin e të gjithë popullsisë së rritur në Kosovë në përgjithësi.

Sa i përket Serbisë, anketa u krye me një mostër përfaqësuese prej 1,095 të anketuarve të rritur që mbulonin 120 vendvotime të shtresuar në nëntë shtresa sipas madhësisë së qendrës së votimit (e vogël/e mesme/e madhe) dhe përfshiu rajonin e Vojvodinës, Beogradit dhe Serbinë Qendrore. Në secilën shtresë, numri i vendvotimeve ku u krye hulumtimi në terren u përcaktua në përputhje me pjesën e popullsisë në atë shtresë në lidhje me popullsinë totale të votuesve sipas listës së zgjedhësve nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2020: "Vojvodina e vogël" - 1; "Vojvodina mesatare" - 10; "Vojvodina e madhe" - 20; "Beogradi e vogël" - 0; "Beogradi mesatare" - 4; "Beogradi e madhe" - 26; "Serbia Qendrore e vogël" - 9; "Serbia Qendrore mesatare" - 20; "Serbia Qendrore e madhe" - 30. Brenda secilës nga nëntë shtresat, mostrimi ishte i rastësishëm, me tre etapa: vendvotimet e zgjedhura brenda secilës shtresë u përcaktuan me metodën PPS (probabiliteti proporcional me mostrimin e madhësisë), amvisëritë në të cilat u krye anketa u përcaktuan rastësisht në varësi të lloji i vendbanimit - rural/urban; lloji i ndërtesës - shtëpi/banesë; katet e ndërtesave - ndërtesa të ulëta/të larta; ndërsa të anketuari në një amvisëri u përcaktuan me kriterin e ditëlindjes së parë pasuese.

Të dhënat u verifikuan në kohë reale përmes koordinatoreve në terren që vizituan një mostër të paracaktuar të amvisërive pas përfundimit të anketës në amvisëritë përkatëse. Kjo u ndërmor më tej përmes kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa prej përgjigjeve kyçe, si dhe për analizimin e qëndrueshmërisë logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzhi i gabimit është 3 për qind me një interval besueshmërie prej 95 për qind. Përpunimi dhe analiza e të dhënave u realizua duke përdorur softuerin SPSS.

Shifrat e mëposhtme paraqesin të dhënat demografike të të anketuarve në Kosovë dhe Serbi në kuadër të BSBP-së 2020:

FIGURA I TË ANKETUARIT E BSBP0-SË 2020 SIPAS RAJONEVE

KOSOVA		SERBIA	
RAJONI	% TË ANKETUARVE	RAJONI	% TË ANKETUARVE
Prishtinë	22%	Vojvodinë	27%
Mitrovicë e Jugut	11%	Beogradi	24%
Gjilan	12%	Serbi perëndimore dhe Shumadijë	27%
Pejë	13%	Serbi jugore dhe lindore	21%
Gjakovë	11%		
Prizren	15%		
Ferizaj	12%		
Mitrovicë e Veriut	4%		

FIGURA II TË ANKETUARIT E BSBP-SË 2020 SIPAS ZONAVE

KOSOVA		SERBIA		
ZONA	% TË ANKETUARVE	ZONA	% TË ANKETUARVE	
RURALE	50%	RURALE	35%	
URBANE	50%	PERIFERI URBANE	19%	
		URBANE		46%

FIGURA III TË ANKETUARIT E BSBP-SË 2020 SIPAS PËRFAQËSIMIT GJINOR

KOSOVA		SERBIA	
GJINIA	% TË ANKETUARVE	GJINIA	% TË ANKETUARVE
MESHKUJ	45%	MESHKUJ	49%
FEMRA	55%	FEMRA	51%

FIGURA IV TË ANKETUARIT E BSBP-SË 2020 SIPAS MOSHËS

MOSHA	% TË ANKETUARVE
KOSOVA	
18-25	20%
26-35	16%
36-45	18%
46-55	18%
56-65	14%
66+	14%
SERBIA	
18-34	27%
35-54	36%
55 e lart	37%

FIGURA V TË ANKETUARIT E BSBP-SË 2020 SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

PËRKATËSIA ETNIKE	% TË ANKETUARVE
KOSOVA	
Shqiptarë të Kosovës	90%
Serbë të Kosovës	8%
Të tjerë në Kosovë	2%
SERBIA	
Serbë të Kosovës	91%
Të tjerë	9%

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës“Pjetër Bogdani”

352(496.51)(047)

352(497.11)(047)

Plator Avdiu

Respondents' perceptions in Kosovo and Serbia towards public institutions / Plator Avdiu. - Prishtinë : Kosovar Centre for Security Studies, 2020. – 15 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-799-17-1

ISBN 978-9951-799-17-1



9 789951 799171